REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 3975/5 Prot.

Pogradec, më 28 .10.2026

VENDIM

NR. 131 , DATË 27 .10 .2026

PËR
MIRATIMIN NË PARIM TË TRAJTIMIT TË VEÇANTË TË SUBJEKTIT PËRFITUES Z. MALIQ NAZAR PURBOLLARI, TË NDËRTIMIT TË PRISHUR PËR PROJEKTIN "PARKU UJOR DRILON - TUSHEMISHT".

Në mbështetje të; nenit 113 të Ligjit Nr. 8417, datë 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; shkronjës "a" të pikës 1.2 të nenit 9, shkronjave "e", "k" dhe "n" të nenit 54, shkronjës "c" të nenit 64 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligjit Nr.8480, date 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administrates shteterore dhe enteve publike"; Ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave te paluajteshme publike te shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar; Ligjit Nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; nenit 33 të ligjit nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"; Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërise"; Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikes se Shqiperise"; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 409, datë 22.06.2022 "Për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe rregullave për zhvillimin e integruar të zonave të veçanta, si dhe të masave për personat e prekur", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Miratimin, në parim, të fillimit të procedurës së trajtimit të veçantë për subjektin Maliq Nazar Purbollari, posedues i ndërtimit të prishur në pasurinë nr. 3/100, ZK 3664, Fshati Tushemisht, Njësia Administrative Buçimas, Bashkia Pogradec, në kuadër të projektit me interes publik "Parku Ujor Drilon–Tushemisht", sipas nenit 33 të ligjit nr. 20/2020 dhe VKM nr. 409, datë 22.06.2022.

2. Ngarkimin e strukturave përkatëse të Bashkisë Pogradec për të vijuar procedurën e trajtimit të veçantë sipas hapave të rekomanduar në relacion.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

3. Forma përfundimtare e kompensimit, t'i nënshtrohet miratimit të veçantë të Këshillit Bashkiak pas përfundimit të procedurës së vlerësimit dhe verifikimit nga strukturat kompetente.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Kryetari i Bashkisë, Sekretari i Përgjithshëm dhe Administrata e Bashkisë Pogradec.

5. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

U shpall sot më datë 27.10.2026.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

1.Miratuar me 26 vota

2.Vota Pro 26

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 2

5.Zbardhur më date 28.10.2026
